



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 1867 prot.

Pogradec, më 12.05 2025

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues : **"PËR MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: "PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADEÇIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE"**

Me respekt,

**KRYETARI
Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 4 (Katër)

Nr. i i doc Shoqëruese 92 (Nëntëdhjetë e dy)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI**

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____, ____ 2025

**PROJEKT-VENDIM
Nr. ____, DATË ____/____/2025**

PËR

**“MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: “PASTRIMI,
GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADECIT
DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, nenit 23 pika 10, nenit 55 pikat 2 dhe 6, nenit 54 gërma k të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligjit nr. 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 156, datë 10.10.2013 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, në nenet 12, 41 dhe 85 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar, VKB-së nr. 24, datë 27.03.2025 “Për miratimin e tavaneve përgatitore buxhetore për Vitet 2026-2028”, VKB-së nr. 141, datë 27.12.2024 “Për miratimin dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec për Vitin 2025”, si dhe referuar Kërkesës me nr. 4968 Prot, datë 06.12.2024, me lëndë “Kërkesë për marrje angazhimi për: “Pastrim, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative” të paraqitur nga Sektori i Supervizimit të Shërbimeve pranë Drejtorisë së Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i tokës bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:



1. Të miratojë koston e kryerjes së shërbimit me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative", për një periudhë prej 48 muajsh.

2. Fondi financiar sipas pikes 1 të këtij vendimi, për kryerjen e ishërbimit, mbështetet në PBA-në 2026-2028 dhe merr angazhimin për të planifikuar me prioritet në Buxhetin e Vitit 2029 dhe në PBA-në 2027-2029.. Ndarja e fondeve dhe efektet financiare, e përlogaritur per 48 (dyzet e tetë) Muaj, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i objektit	Vlera e plotë (lekë me tvsh)	Fondi për vitin 2025	Fondi për vitin 2026	Fondi për vitin 2027	Fondi për vitin 2028	Fondi për vitin 2029
1.	"Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative"	523,598,619	54,541,522	130,899,655	130,899,655	130,899,655	76,358,132

3. Të miratojë standardin e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas dokumentacionit bashkengjitur: (Preventivë për Qytetin Pogradec dhe Njësitë Administrative, Specifikime teknike, Harta për vendosjen e kontenierëve, Harta për fshirjen e rrugëve, Harta për lagjen e rrugëve dhe larjen e shesheve, Harta për pastrimin e thelluar të lumenjve, Harta për mirëmbajtjen e rrugëve ditën).

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Pogradec, Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i tokës bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve, Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Prokurimeve pranë Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë sipas përcaktimeve pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 1867 Prot.

Pogradec, më 12.03.2025

RELACION

PËR

**MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: "PASTRIMI,
GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË
POGRADECIT DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE"**

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Bashkia Pogradec, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, në mbështetje të nenit 23, pika 10 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ku cilësohet se: *Bashkitë ndër të tjera janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për "Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake".*

Duke qene se kontrata e shërbimit të pastrimit, përfundon në Muajin Gusht 2025, si rrjedhojë bëhet i domosdoshëm planifikimi i mirëfilltë i shërbimit të pastrimit për periudhën në vazhdim.

Bashkitë janë të përfshira në çdo fazë të procesit të menaxhimit të mbetjeve, nga planifikimi dhe mbledhja, deri te edukimi dhe zbatimi i legjislacionit për pastrimin e mjedisit.

Për sa më sipër, po rendisim disa nga arsyet e realizimit për një periudhë 48 Muaj, si më poshtë vijon:

1. Nevoja për Shërbimin e Pastrimit dhe Grumbullimit të Mbetjeve Urbane

Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane është një shërbim thelbësor për mirëmbajtjen e higjienës publike dhe mjedisit, si në qytet ashtu edhe në njësitë administrative. Ky shërbim përfshin mbledhjen, transportimin dhe largimin e mbetjeve të ndryshme nga zona urbane dhe rurale, duke kontribuar në mbrojtjen e shëndetit të popullsisë dhe ruajtjen e mjedisit.

Bazuar në numrin e popullsisë, numrin e turistëve përgjatë sezonit turistik, sasia e mbetjeve të prodhuara ka pasur tendencë në rritje gjithashtu, duke bërë të domosdoshëm një planifikim të mirëfilltë dhe një implementim efikas të shërbimeve të pastrimit.



2. Stabiliteti i Shërbimit, Planifikimi Afatgjatë dhe Vazhdimësia e shërbimit:

Shërbimi i pastrimit, grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të ofrohet për një afat 48 – Muaj, pasi:

- Një kontratë afatgjatë ofron mundësinë për të krijuar një plan afatgjatë dhe të qëndrueshëm për grumbullimin dhe pastrimin e mbetjeve urbane dhe rurale.

- Ofron stabilitet dhe mundëson që ofruesi i shërbimit të investojë në pajisje, trajnime dhe burime të nevojshme për të ofruar një shërbim të qëndrueshëm dhe sa më cilësor.

- Një periudhë afatgjatë lejon optimizimin e burimeve dhe menaxhimin e shpenzimeve për shërbimet e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve, duke siguruar një proces efikas dhe të mirë organizuar.

- Pastrimi është një shërbim që kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe të rregullt. Një kontratë 48 Mujore garanton që shërbimi i pastrimit të jetë i disponueshëm, pa ndërprerje dhe se përkujdesi për pastrimin e hapësirave do të jetë në nivelin e duhur.

3. Kostoja dhe Efikasiteti

- Një kontratë 48 Mujore u mundëson palëve kontraktuese të dakordësohen për një çmim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm gjatë gjithë periudhës, duke siguruar që shërbimi të ofrohet pa vonesa dhe pa ndryshime të papritura të çmimit. Kjo i jep mundësi Bashkisë të planifikojë buxhetin e saj në mënyrë më të qartë dhe të parashikueshme.

4. Përshtatshmëria dhe Përmirësimi i Shërbimit

- Për shkak të natyrës së ndryshueshme të kërkesave për shërbimin e pastrimit, kontratat afatgjata i japin mundësi për të kryer vlerësime periodike të performancës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, bazuar në reagimet e qytetarëve dhe analizat e situatës.



5. Angazhimi i Palëve dhe Mbështetjen për Zhvillimin e Mjedisit

- Një kontratë 48 Mujore krijon një mundësi të mira për të ndihmuar në zhvillimin e shërbimeve të mbetjeve urbane, përfshirë menaxhimin e riciklimit, përdorimin e teknologjive të reja dhe implementimin e praktikave të qëndrueshme që mbrojnë mjedisin.

6. Përshtatshmëria me Rregulloret Ligjore dhe Standardet Ndërkombëtare

- Një periudhë 48 Mujore e kontratës mund të ndihmojë në implementimin e rregulloreve dhe standardeve të reja, si ato të përcaktuara nga ligji shqiptar dhe standardet ndërkombëtare për menaxhimin e mbetjeve dhe ruajtjen e mjedisit, duke garantuar që shërbimi ofrohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe mjedisore.

Lidhja e kontratës për këtë shërbim do të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor.

Për sa më sipër, kërkojmë miratimin e kryerjes së shërbimit me objekt: "Grumbullim dhe transport i mbetjeve urbane për një periudhë prej 48 (dyzet e tetë Muajsh)".

Bashkangjitur materiale:

- 1.Preventivë Përmbledhës për Qytetin Pogradec dhe Njësitë Administrative
- 2.Specifikime teknike
3. Harta për vendosjen e kontenerëve
- 4.Harta për fshirjen e rrugëve

5. Harta për lagjen e rrugëve dhe larjen e shesheve
6. Harta për pastrimin e thelluar të lumenjve
7. Harta për mirëmbajtjen e rrugëve ditën.



GRUPI I PUNËS:
Perfaqësuar nga Kryetari i Grupit:
Bardhyl KASTRIOTI

Drejtorja e Emergjencave,
Strehimit dhe Administrimi i Tokës Bujqësore
në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve:

Drejtore
Besmira NIKO

DREJTORIA E EKONOMISË DHE
MENAXHIMIT FINANCIAR

Drejtore
Irsa KARAPANÇA

MIRATOI:
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Dritan BABASULI

Duke pasur besim te plote, ju ftojme te miratoni projekt vendimin e paraqitur.

Ju faleminderit!

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 1867 Prot

Pogradec, më 12.05.2025

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN

PËR

**“MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT ME OBJEKT: “PASTRIMI,
GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETURINAVE TË QYTETIT TË POGRADECIT
DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE”**

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të



miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon: "**Akt normativ nënligjor**" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij".

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. "Akti administrativ":

a) "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) "Akti administrativ kolektiv" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe me miratimin e tij do të ketë një ndikim të rëndësishëm për komunitetin, dhe për rrjedhojë është i domosdoshëm planifikimi i mirëfilltë i shërbimit të pastrimit për periudhën e 48 muajve në vazhdim, me vlerë totale të fondit limit 523,598,619 (pesëqind e njëzet e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë ku të gjitha Bashkitë ashtu si edhe Bashkia Pogradec janë të përfshira në çdo fazë të procesit të menaxhimit të mbetjeve, nga planifikimi dhe mbledhja, deri te edukimi dhe zbatimi i legjislacionit për pastrimin e mjedisit.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



Nr Protokolli 977 dt 17/12/2024



	Gjendja civile	Pesha specifike	Perilogaritja sipas MFE
Pogradeci	39515	43%	25713
Bucimas	20189	22%	13137
Cerrava	9478	10%	6168
Dardhas	3407	4%	2217
Udenisht	7756	8%	5047
Proptisht	5804	6%	3777
Trebinje	2911	3%	1894
Velcan	2891	3%	1881
Totali	91951	100%	59834
Census 2023	46070		

Bashkia e Pogradecit
Blun

SPARTAK KUQO
NEXHAT SHUTURA
A. H. H.

Violeta Cetani
Q. S.

Klajdi Binsin
P.

**NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (1) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 1]**

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit		Komente
			Zona 1	Zona 2	
A	Emri i NJVV-së	Bashkia Pogradec	Qyteti Pogradec	Njësitë Administrative Udënisht, Buçimas, Çërravë + Dardhas	-
B	Frekuenca e grumbullimit (numri i grumbullimeve për javë)		7	7	Kjo përlllogaritet nga sasia e mbetjeve të gjeneruara dhe zakonisht zbatohet 2 herë në javë ose 7 ditë në javë.
C	Tipologjia		Urbane	Mikse	Urbane, rurale ose mikse. Ky informacion mund të përcaktojë ndryshimet në standardet e operimit, të tilla si koha e harchuar për grumbullim.
D	Popullsia	91 951	39 515	40 830	Vendos shifrën që merret nga regjistri i gjendjes civile, pavarësisht numrit faktit të banuesve gjatë gjithë vitit.
E	% e popullsisë e përfshijtur (regjistruar por që jetojnë jashtë/emigrantë)	%	35	35	Numri i popullsisë së përfshijtur përbëhet zakonisht nga numri i emigrantëve, të cilët jetojnë në më shumë se gjysmën e vitit jashtë njësisë administrative.
F	Popullsia e shërbuer (që merret/considerohet për t'u shërbuer)	59 834	25 713	26 569	Kjo përlllogaritet nga formula D (minus) E. Duke zbritur numrin e popullsisë së përfshijtur nga numri i banorëve të regjistruar.
G	Rrugët (distanca nga fisha e depozitimit, një drejtim)	km	28	37 Udënisht 25 Buçimas 13 Çërravë 27 Dardhas	Zakonisht kjo distancë mbetet e njëjta për vite pasi venddepozitimet ndërtohen për një kohë të gjatë.
H	Rrugët (distanca e përshkruar nga një konicion në një turn)	km	16	34 Udënisht 35 Buçimas 50 Çërravë 8 Dardhas	Kjo përlllogaritet nga matjet në terren, duke vlerësuar distancën që përshkon kamioni deri sa mbushet, po pa kaluar një turn
I	Standardi i gjenerimit të mbetjeve për person	eqv. kg/ban.	0.9	0.7 Udënisht 0.7 Buçimas 0.5 Çërravë 0.3 Dardhas	Përdor standardet e përcaktuara në planet e menaxhimit, por duhet treguar kujdes që të përditësohet sipas faktit, pasi kjo shifër është më përcaktuesja në përlllogaritjen e aseteve dhe kostove përkatëse.
J	Totali i mbetjeve të gjeneruara	t/ditë	23.1	15.3	Përlllogaritur nga formula $D * I/1000$ për të përcaktuar totalin e mbetjeve në kg në ditë
K	Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara të ndërmjet 2 grumbullimeve, bazuar në frekuencën e grumbullimit (B)	t	23.1	15.3	Përlllogaritet me formulë. Nëse grumbullimi është çdo ditë, atëherë shifra është e barabartë me J, përndryshe, nëse është 2 herë në javë, përlllogaritet sasia e mbetjeve që gjenerohet në ditët pa shërbim.
L	Sasia totale e mbetjeve të gjeneruar në 12 muaj	t/12 muaj	8 431,5	5585	Përlllogaritur nga formula $J * 365$ ditë









NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (2) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 2]



Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i Zerit		Komente
			Zona 1	Zona 2	
A	Tipi i kamionit Tipi i kamionit	Tonë Tonë	12 5	5	Zakonisht këtu do të shfaqen tipi 5t ose 10t, por mund të jenë dhe më të vegjël ose më të mëdhenj.
B	Kapaciteti mbushës i kamionit	Tonë Tonë	10.2 4.3	4.3	Përlogaritet nga formula 85% e kapacitetit mbajtës (85% * A). Kjo për shkak se mbetjet kanë densitet të ulët dhe krijojnë volum, e cila mbush kamionin pa mbërritur peshën.
C	Turnet	Numër	2	1	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve të gjeneruar (TICI-K) dhe kapacitetin e kamionit, për të përcaktuar 1 ose dy turne ditore.
D	Kamionë (sasija)	Numër	2	3	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve të gjeneruar dhe numrin e turneve. Për NJVV-të e mëdha me mbi 50.000 banorë rekomandohet të shtohet dhe një kamion rezervë në rast avarie.
E	Kapaciteti i kazanëve	Tonë	0.10	0.10	Tipi i kazanëve më i përdorur është 1,1 m ³ , i cili mund të mbajë deri në 0,10 ton mbetje. Por, kjo shifër është subjekt rishikimi, duke marrë parasysh se densiteti i mbetjeve është përcaktues për masën.
F	Kazanë (total)	Numër	130	180	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve që gjenerohet dhe kapacitetin mbajtës të kazanëve.
G	Kostoja e kamionëve	Lekë	---	---	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar koston e një kamioni (kostoja merret nga tregu, mund të jetë kamion i ri ose i përdorur) duke e shumëzuar me numrin e kamionëve
H	Kostoja e kazanëve (të gjithë kazanët)	Lekë	---	---	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar koston e një kazani (kostoja merret nga tregu, mund të jetë kazan i ri ose i përdorur) duke e shumëzuar me numrin e kazanëve
I	Totali i investimeve	Lekë	---	---	Përlogaritur nga formula (G + H)

Blucop

S

Shk

Abaz

CP



NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (3) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 3]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zerit		Komente
			Zona 1	Zona 2	
A	Sigurimet dhe taksat për kamionët	Lekë/kamionë/vit	250 000	300000	Shifra vjen nga taksat kombëtare për tipin e kamionit të përdorur
B	Vaj dhe filtra	Lekë/kamionë/vit	255 000	300000	Vlera është e përcaktuar nga tipi i kamionit dhe përdorimi i kamionit në km
C	Gomat	Lekë/kamionë/vit	480 000	640000	Ndërimi i gomave varet nga konsumi i tyre dhe mund të mos jetë në bazë vjetore.
D	Mirëmbajtja mekanike	Lekë/kamionë/vit	600 000	800000	Sasia e parave të kërkuara për mirëmbajtjen vjen nga përvoja dhe nga përdorimi.
E	Parkimi	Lekë/kamionë/6 muaj	100 000	150000	Sasia e parave të kërkuara për parkimin bazohet në realitetin e njesisë. Nëse NJVV-ja ka token e saj, mund të ulë kostot e parkimit duke ndërtuar një park për të gjitha mjetet e të gjitha departamenteve.
F	Kostot totale të mirëmbajtjes	Lekë/12muaj	1 685 000	300 000 * 3 =900 000	Përfllogaritur nga formula (SUM=A:E) * numri i kamionëve



NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (3) TË SISTEMIT TË

LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 3]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zerit		Komente
			Zona 1	Zona 2	
A	Ditë shërbimi	ditë/vit	365	182	Përlogaritur me formulë, bazuar në ditët në shërbim.
B	Koha e nevojshme për të ngarkuar një kamion në një herë – koha e grumbullimit	h	6	8	Shifër e përcaktuar nga tipi i njësisë.
C	Koha e nevojshme për grumbullim (totali)	h/ditë	6	8	Përlogaritur nga formula (nr. kamionë * kohë/kamion * nr. e turneve).
D	Koha e nevojshme për shkarkim në fushëdepozitimi	h	0.9	Udënisht 0.3 Buçimas 0.3 Çërravë + Dardhas 0.3	Vjen nga përvoja (0,3 h), por për t'u verifikuar sipas matjeve.
E	Sasia e karburantit të harxhuar gjatë grumbullimit	lt/ditë	96.8	Udënisht 32.6 Buçimas 48 Çërravë + Dardhas 29.8	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar shumë faktorë, të tillë si: numri i kamionëve, turnet, koha për grumbullim, koha për shkarkim dhe normën e harxhimit të kamionit.
F	Sasia totale e karburantit të harxhuar gjatë 12 muajve (365 ditë), vetëm për grumbullim	lt/12muaj	35 331 * 131lek/l= 4 628 492 lek	Udënisht 11889*131lek/l = 1 557 459lek Buçimas 17520 * 131lek/l= 2 295 120lek Çërravë + Dardhas 10887 * 131 lek/l= 1 424 887lek	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar normën e konsumit dhe kohën totale të shpenzuar nga të gjithë kamionët gjatë grumbullimit.
G	Shpejtësia e lëvizjes	km/h	40	40	Përcaktohet nga tipi i kamionit dhe gjendja e tij, si dhe nga cilësia e rrugëve.
H	Koha e harxhuar për transportimin në fushëdepozitimi	h	1.4	Udënisht 0.9 Buçimas 0.7 Çërravë + Dardhas 0.75	Përlogaritur me formulë, bazuar në numrin e kamionëve, turneve dhe kohës së harxhuar për të shkuar në fushë depozitimi dhe kohën e shkarkimit.
I	Koha totale e harxhuar për transportin (në një ditë/të gjithë kamionët)	h/ditë	1.7	Udënisht 1.2 Buçimas 0.8 Çërravë + Dardhas 0.9	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar numrin e kamionëve, turneve dhe distancës nga fusha e depozitimit * një rrugë të plotë vajtje-ardhje.

[Handwritten signatures and initials in blue ink]

J	Karburanti i harxhuar gjatë transportit	lt/ditë	72.8	Udënisht 28 Buçimas 40 Çërravë + Dardhas 12.8	Përllogaritur me formulë, duke konsideruar normën e konsumit dhe kohën totale për të gjithë kamionët gjatë transportit.
K	Sasia totale e karburantit të harxhuar gjatë 12 muajve (365 ditë), vetëm për transport	lt/12 muaj	26572 liter /vit*131 lek/lit = 3 480 932 lek/vit	Udënisht 10220*131=1 338 820 Buçimas 14600 * 131 = 1 912 600 Çërravë + Dardhas 4672*131=612 032	Përllogaritur me formulë, duke konsideruar sasinë totale të karburantit të harxhuar gjatë transportit + çmimin e karburantit për lt.

NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (3) TË SISTEMIT TË LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 3]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit		Komente
			Zona 1	Zona 2	
A	Koha maksimale e punës	h/ditë	6	6	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i Punës duhet të merret parasysh këtu.
B	Numri maksimal i ditëve të punës për javë	Ditë/javë	7	7	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i Punës duhet të merret parasysh këtu.
C	Koha maksimale e punës në javë	h/javë	42	42	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i Punës duhet të merret parasysh këtu.
D	Mirëmbajtje [% e kohës së punës]	%	5	16	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit.
E	Pushime [% e kohës së punës]	%	5	8	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. E rëndësishme për aspektin ligjor dhe social.
F	Sasia e shoferëve	Numër	3	4	Përllogaritur me formulë, duke konsideruar, kohën totale të harxhuar nga një shofer, limituar nga numri i turneve dhe Kodi i Punës për kohën maksimale të punës (A) dhe kohën e nevojshme për pushim.

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]



G	Paga për shofer (të gjithë shoferët)	<i>Lekë/12muaj</i>	2 730 780	3 641 040	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar pagën bruto për çdo shofer * numrin e shoferëve në shërbim. Paga e shoferëve është subjekt ndryshimi.
H	Sasia e punonjësve / operatorëve	<i>Numër</i>	6	8	Përlogaritur me formulë, bazuar në numrin e shoferëve dhe standardit për përcaktimin e 2 operatorëve për çdo kamion.
I	Punonjësit shoqërojnë kamionin në fushë depozitimi	<i>Tekst</i>	JO	JO	Kjo është e rëndësishme për t'u përcaktuar me Po ose Jo, pasi shërben për rilogaritjen automatike të numrit të punonjësve dhe eficiencën e kohës. Në një praktikë të mirë, operatorët nuk duhet të shkojnë në fushë depozitimi.
J	Paga për punonjës (të gjithë punonjësit)	<i>Lekë/6muaj</i>	4 201 200	5 601 600	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar pagën bruto * numrin e punonjësve në shërbim. Paga e punonjësve është subjekt ndryshimi.
K	Kosto totale për personelin për 12muaj (365ditë)	<i>Lekë</i>	6 931 980	9 242 640	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar totalin e shoferëve + të punonjësve.

**NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (4) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 4]**

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Tarifa e trajtimit Landfill	<i>Lekë/tonë</i>		Tarifa përcaktohet nga operatori/autoriteti që menaxhon njësinë e trajtimit dhe fiksohet në kontratë mes palëve.
B	Kostoja totale për trajtim në impiante	<i>Lekë/tonë/ditë</i>		Përlogaritet me formulë, duke konsideruar, sasinë e mbetjeve, e cila dërgohet njësinë trajtuese çdo ditë * tarifën hyrëse për tonë.
C	Kosto totale për trajtim në impiante 6muaj (182ditë)	<i>Lekë/6muaj</i>		Përlogaritet me formulë, duke konsideruar sasinë totale të mbetjeve të gjeneruar në 6muaj (e gjithë sasia dërgohet në trajtim) * A.









NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (5) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 5]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Amortizimi i kamionit, vite	Numër	6	Kjo shifër do të jetë 5 vite, nëse konsiderojmë një mesatare vjetore prej 20%.
B	Kostot e amortizimit të kamionit	Lekë/12 muaj	4 050 550	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar numrin e kamionëve, koston për një kamion dhe shkallën e amortizimit në 6 muaj.
C	Amortizimi i kazanëve në vite	Numër	300	Kjo shifër do të jetë 5 vite, nëse konsiderojmë një mesatare vjetore prej 20%. Por, kjo është subjekt verifikimi në bazë të përdorimit të kazanëve.
D	Kostot e mirmbajtjes të kazanëve	Lekë/12 muaj	735 000	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar numrin e kazanëve, çmimin e një kazani dhe shkallën e amortizimit në 12 muaj.

NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (6) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 6]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Kostoja e administrimit	%	9	Përlogaritur nga formula si % e kostove totale operacionale.
B	Kostot administrative të tjera (p.sh. për grumbullim të tarifës)	%	0	Përlogaritur nga formula si xx% e kostove totale operacionale.
C	Kostot administrative për fushat e ndërgjegjësimit	%	0	Përlogaritur nga formula si xx% e kostove totale operacionale.
D	Kostot administrative	Lekë/12 muaj	3 787 814	Përlogaritur me formulë (%A+B+C * total operacione).
E	Të ardhura neto	Lekë/12 muaj	3 787 814	Përlogaritur nga formula (% * total operacione).





Njësitë Administrative Proptisht, Velçan, Trebinjë

NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (1) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 1]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Emri i NJVV-së	-	Njësitë Administrative Proptisht Velçan Trebinjë	-
B	Frekuenca e grumbullimit (numri i grumbullimeve për	Numër	2	Kjo përlogaritet nga sasia e mbetjeve të gjeneruara dhe zakonisht zbatohet 2 herë në javë ose 7 ditë në javë.
C	Tipologjia	-	Rurale	Urbane, rurale ose mikse. Ky informacion mund të përcaktojë ndryshimet në standardet e operimit, të tilla si koha e harxhuar për grumbullim.
D	Popullsia	Numër	11 606	Vendos shifrën që merret nga regjistri i gjendjes civile, pavarësisht numrit faktit të banuesve gjatë gjithë vitit.
E	% e popullsisë e përjashtuar (regjistruar por që jetojnë jashtë/emigrantë)	%	35	Numri i popullsisë së përjashtuar përbëhet zakonisht nga numri i emigrantëve, të cilët jetojnë në më shumë se gjysmën e vitit jashtë njësisë administrative.
F	Popullsia e shërbyer (që men/considerohet për t'u shërbyer)	Numër	7 552	Kjo përlogaritet nga formula D (minus) E. Duke zbritur numrin e popullsisë së përjashtuar nga numri i banorëve të regjistruar.
G	Rrugët (distanca nga fusha e depozitimit, një drejtim)	km	Proptisht 76 Velçan 90 Trebinjë 48	Zakonisht kjo distancë mbetet e njëjta për vite pasi venddepozitimet ndërtohen për një kohë të gjatë.
H	Rrugët (distanca e përshkuar nga një kamion në një turn)	km	Proptisht 90 Velçan 30 Trebinjë 28	Kjo përlogaritet nga matjet në terren, duke vlerësuar distancën që përshkon kamioni deri sa mbushet, po pa kaluar një turn
I	Standardi i gjenerimit të mbetjeve për person	eqv. kg/ban.	0.3	Përdor standardet e përcaktuara në planet e menaxhimit, por duhet treguar kujdes që të përditësohet sipas faktit, pasi kjo shifër është më përcaktuesja në përlogaritjen e aseteve dhe kostove përkatese.
J	Totali i mbetjeve të gjeneruara	t/ditë	Proptisht 1.1 Velçan 0.60 Trebinjë 0.60	Përlogaritur nga formula $D * I / 1000$ për të përcaktuar totalin e mbetjeve në kg në ditë

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

K	Sasia totale e mbetjeve të gjeneruara ndërmjet 2 grumbullimeve, bazuar në frekuencën e grumbullimit (B)	t	Proptisht 1.1 Velçan 0.60 Trebinjë 0.60	Përlogaritët me formulë. Nëse grumbullimi është çdo ditë, atëherë shifra është e barabartë me J, përndryshe, nëse është 2 herë në javë, përlogaritët sasia e mbetjeve që gjenerohet në ditët pa shërbim.
L	Sasia totale e mbetjeve të gjeneruar në vit	t/vit	Proptisht 414 Velçan 207 Trebinjë 207	Përlogaritur nga formula $J * 365$ ditë

NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (2) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 2]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Tipi i kamionit	Tonë	5	Zakonisht këtu do të shfaqen tipi 5t ose 10t, por mund të jenë dhe më të vegjëll ose më të mëdhenj.
B	Kapaciteti mbushës i kamionit	Tonë	4.25	Përlogaritët nga formula 85% e kapacitetit mbajtës ($85\% * A$). Kjo për shkak se mbetjet kanë densitet të ulët dhe krijojnë volum, e cila mbush kamionin pa mbërritur peshën.
C	Turnet	Numër	1	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve të gjeneruar (T1C1-K) dhe kapacitetin e kamionit, për të përcaktuar 1 ose dy turne ditore.
D	Kamionë (sasia)	Numër	1	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve të gjeneruar dhe numrin e turneve. Për NJVV-të e mëdha me mbi 50.000 banorë rekomandohet të shtohet dhe një kamion rezervë në rast avarie.
E	Kapaciteti i kazanëve	Tonë	0.10	Tipi i kazanëve më i përdorur është $1,1 \text{ m}^3$, i cili mund të mbajë deri në 0,10 ton mbetje. Por, kjo shifër është subjekt rishikimi, duke marrë parasysh se densiteti i mbetjeve është përcaktues për masën.
	Kazanë (total)	Numër	95	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar sasinë e mbetjeve që gjenerohet dhe kapacitetin mbajtës të kazanëve.

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]



F	Kostoja e kamionëve (të gjithë kamionët)	Lekë	0	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar koston e një kamioni (kostoja merret nga tregu, mund të jetë kamion i ri ose i përdorur) duke e shumëzuar me numrin e kamionëve
G	Kostoja e kazanëve (të gjithë kazanët)	Lekë	0	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar koston e një kazani (kostoja merret nga tregu, mund të jetë kazan i ri ose i përdorur) duke e shumëzuar me numrin e kazanëve
H	Totali i investimeve	Lekë	0	Përlogaritur nga formula (G + H)

NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK(3) TË SISTEMIT
TË

LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 3]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Sigurimet dhe taksat për kamionët	Lekë/kamionë/vit	100 000	Shifra vjen nga taksat kombëtare për tipin e kamionit të përdorur
B	Vaj dhe filtra	Lekë/kamionë/vit	75 000	Vlera është e përcaktuar nga tipi i kamionit dhe përdorimi i kamionit në km
C	Gomat	Lekë/kamionë/vit	16 000	Ndërrimi i gomave varet nga konsumi i tyre dhe mund të mos jetë në bazë vjetore.
D	Mirëmbajtja mekanike	Lekë/kamionë/vit	200 000	Sasia e parave të kërkuara për mirëmbajtjen vjen nga përvoja dhe nga përdorimi.
E	Parkimi	Lekë/kamionë/vit	50 000	Sasia e parave të kërkuara për parkimin bazohet në realitetin e njësisë. Nëse NJVV-ja ka tokën e saj, mund të ulë kostot e parkimit duke ndërtuar një park për të gjitha mjetet e të gjitha departamenteve.
F	Kostot totale të mirëmbajtjes	Lekë/vit	585 000	Përlogaritur nga formula (SUM=A:E) * numri i kamionëve

NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (3) TË SISTEMIT TË

LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 3]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]



Ref.	Zërat	Njësia matës	Përdorimi i zërit	Komente
A	Ditë shërbimi	dite/vit	312	Përlogaritur me formulë, bazuar në ditët në shërbim.
B	Koha e nevojshme për të ngarkuar një kamion në një herë – koha e grumbullimit	h	8	Shifër e përcaktuar nga tipi i njësisë.
C	Koha e nevojshme për grumbullim (totali)	h/ditë	8	Përlogaritur nga formula (nr. kamionë * kohë/kamion * nr. e turneve).
D	Koha e nevojshme për shkarkim në fushëdepozitimi	h	0.3	Vjen nga përvoja (0,3 h), por për t'u verifikuar sipas matjeve.
E	Sasia e karburantit të harxhuar gjatë grumbullimit	lt/ditë	Proptisht 45 Velçan 21 Trebinjë 21	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar shumë faktorë, të tillë si: numri i kamionëve, turnet, koha për grumbullim, koha për shkarkim dhe normën e harxhimit të kamionit.
F	Sasia totale e karburantit të harxhuar gjatë gjithë vitit, vetëm për grumbullim	lt/vit	9048	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar normën e konsumit dhe kohën totale të shpenzuar nga të gjithë kamionët gjatë grumbullimit.
G	Shpejtësia e lëvizjes	km/h	40	Përcaktohet nga tipi i kamionit dhe gjendja e tij, si dhe nga cilësia e rrugëve.
H	Koha e harxhuar për transportimin në fushëdepozitimi	h	0.8	Përlogaritur me formulë, bazuar në numrin e kamionëve, turneve dhe kohës së harxhuar për të shkuar në fushë depozitimi dhe kohën e shkarkimit.
I	Koha totale e harxhuar për transportin (në një ditë/të gjithë kamionët)	h/ditë	0.8	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar numrin e kamionëve, turneve dhe distancës nga fusha e depozitimit * një rrugë të plotë vajtje-ardhje.
J	Karburanti i harxhuar gjatë transportit	Lt/ ditë	Proptisht Velçan Trebinjë Totali 56.8	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar normën e konsumit dhe kohën totale për të gjithë kamionët gjatë transportit.
K	Sasia totale e karburantit të harxhuar gjatë gjithë vitit, vetëm për transport	lt/vit	Proptisht Velçan Trebinjë 17 721 Totali	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar sasinë totale të karburantit të harxhuar gjatë transportit * çmimin e karburantit për lt.



NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (3) TË SISTEMIT TË
LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 3]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Koha maksimale e punës	h/ditë	8	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i Punës duhet të merret parasysh këtu.
B	Numri maksimal i ditëve të punës për javë	Ditë/javë	6	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i Punës duhet të merret parasysh këtu.
C	Koha maksimale e punës në javë	h/javë	42	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. Kodi i Punës duhet të merret parasysh këtu.
D	Mirëmbajtje [% e kohës së punës]	%	7.3	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit.
E	Pushime [% e kohës së punës]	%	7.7	Kjo shifër është e rëndësishme për përcaktimin e numrit të personelit, duke shmangur orët e punës jashtë orarit. E rëndësishme për aspektin ligjor dhe social.
F	Sasia e shoferëve	Numër	1	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar kohën totale të harxhuar nga një shofer, limituar nga numri i turneve dhe Kodi i Punës për kohën maksimale të punës (A) dhe kohën e nevojshme për pushim.
G	Paga për shofer (të gjithë shoferët)	Lekë/vit	910 260	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar pagën bruto për çdo shofer * numrin e shoferëve në shërbim. Paga e shoferëve është subjekt ndryshimi.
H	Sasia e punonjësve / operatorëve	Numër	2	Përlogaritur me formulë, bazuar në numrin e shoferëve dhe standardit për përcaktimin e 2 operatorëve për çdo kamion.
I	Punonjësit shoqërojnë kamionin në fushë depozitimi	Tekst	JO	Kjo është e rëndësishme për t'u përcaktuar me Po ose Jo, pasi shërben për rillogaritjen automatike të numrit të punonjësve dhe eficientësinë e kohës. Në një praktikë të mirë, operatorët nuk duhet të shkojnë në fushë depozitimi.
J	Paga për punonjës (të gjithë punonjësit)	Lekë	1 400 400	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar pagën bruto * numrin e punonjësve në shërbim. Paga e punonjësve është subjekt ndryshimi.
K	Kosto totale për personelin	Lekë	2 310 660	Përlogaritur nga formula, duke konsideruar totalin e shoferëve + të punonjësve.



NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (4) TË SISTEMIT
TË

LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 4]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Tarifa e trajtimit	Lekë/tonë	0	Tarifa përcaktohet nga operatori/autoriteti që menaxhon njësinë e trajtimit dhe fiksohet në kontratë mes palëve.
B	Kostoja totale për trajtim në impiante	Lekë/tonë/ditë	0	Përlogaritet me formulë, duke konsideruar, sasinë e mbetjeve, e cila dërgohet njësinë trajtuese çdo ditë * tarifën hyrëse për tonë.
C	Kosto totale për trajtim në impiante	Lekë/vit	0	Përlogaritet me formulë, duke konsideruar sasinë totale të mbetjeve të gjeneruar në vit (e gjithë sasia dërgohet në trajtim) * A .

NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK (5) TË SISTEMIT
TË

LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 5]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Amortizimi i kamionit, vite	Numër	6	Kjo shifër do të jetë 5 vite, nëse konsiderojmë një mesatare vjetore prej 20%.
B	Kostot e amortizimit të kamionit	Lekë/vit	717 600	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar numrin e kamionëve, koston për një kamion dhe shkallën e amortizimit në vit.
C	Amortizimi i kazanëve në vite	Numër	95	Kjo shifër do të jetë 5 vite, nëse konsiderojmë një mesatare vjetore prej 20%. Por, kjo është subjekt verifikimi në bazë të përdorimit të kazanëve.
D	Kostot e amortizimit të kazanëve	Lekë/vit	266 000	Përlogaritur me formulë, duke konsideruar numrin e kazanëve, çmimin e një kazani dhe shkallën e amortizimit në vit.



NDËRTIMI I NJË TABELË LLOGARITJESH PËR KËTË BLOK(6) TË SISTEMIT
TË

LLOGARITJES SË KOSTOS [TC 6]

Ref.	Zërat	Njësia matëse	Përdorimi i zërit	Komente
A	Kostoja e administrimit	%	9	Përlogaritur nga formula si % e kostove totale operacionale.
B	Kostot administrative të tjera (p.sh. për grumbullim të tarifës)	%	0	Përlogaritur nga formula si xx% e kostove totale operacionale.
C	Kostot administrative për fushat e ndërgjegjësimit	%	0	Përlogaritur nga formula si xx% e kostove totale operacionale.
D	Kostot administrative	Lekë/vit	664 746	Përlogaritur me formulë (%A+B+C * total operacione).
E	Të ardhura neto	Lekë/vit	664 746	Përlogaritur nga formula (% * total operacione).

GRUPI I PUNËS:

Bashkëpunuesit *[Signature]*
Violeta Cokani *[Signature]*
SPARIM KUCO *[Signature]*
NEXHAT SHIUPA *[Signature]*
Kloja Birzani *[Signature]*



Specifikimet Teknike për Objektivin: "Pastrimi, Grumbullimi dhe Largimi i Mbeturinave të Qytetit Pogradec dhe Njësi Administrative"

1.1 Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane Familjare +Plazhi.

1.1.1 Volumet e punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e 405 kontenierëve me volum 1.1 m³, brënda zonës së kontraktuar ose 40.7 ton në ditë. Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, ku janë parashikuar të zbrazen: në qytet pastrimi bëhet me dy turne, janë të vendosur 130 kontenierë dhe tonazhi ditor është parashikuar 23.1 ton në ditë, të konvertuara në 198 zbrazje (23.1 ton / 0.117 ton/kazan) , 50 kontenierë (zbrazje) në Njësinë Administrative Udënisht, 80 kontenierë (zbrazje) në Njësinë Administrative Buçimas ku pastrimi bëhet me dy turne, 50 Kontenierë (zbrazje) në Njësitë Administrative Dardhas + Çërravë, në Njësinë Administrative Velcan 25 konteniere (zbrazje), Njësia Administrative Trebinjë 25 kontenierë (zbrazje) dhe në Njësinë Administrative Proptisht 45 konteniere (zbrazje) ku është parashikuar largimi i mbetjeve dy herë në javë ose 104 herë në vit për këto tre Njësi Administrative dhe depozitimin e tyre në Landfillin Maliq.

1.1.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve urbane konsiston në: Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30 m² rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre. Ky shërbim do të kryhet çdo ditë 7 herë/javë pra 365 ditë punë në vit në Qytet dhe Njësitë Administrative Udënisht, Buçimas, Dardhas + Çërrave dhe për Njësitë Velcan, Trebinjë dhe Proptisht është parashikuar largimi i mbetjeve dy herë në javë ose 104 herë në vit dhe depozitimin e tyre në Landfillin në Maliq.

1.1.3 Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve

a. Autoriteti kontratues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat e saktë të grumbullimit të mbetjeve të urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha zonës së kontraktuar.

b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës nga operatori i shërbimit ose nga Autoriteti kontratues sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës të njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontraktues.

1



c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën pikë kontenerësh. 2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse. 4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

d. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës, duke filluar jo më parë se ora 19.00, me qëllim që në orën 7.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues, ndryshimet në Grafikun e Punimeve.

e. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjoka për mospërmbushjen e tyre.

1.1.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonën përreth kontenerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit në Nenin "Gjoka dhe penalitetet"

b. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambiente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim Autoritetin kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me Autoritetin kontratues.

2

d. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një "Zyrë të Kontaktimit" për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

e. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

f. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

h. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

i. Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penaltetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjoba të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

j. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjoba për mosplotësim këtij detyrimi.

1.1.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

- Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 deri 12 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, standardi euro 5, jo më pak se 2 (dy) copë;
- Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5 deri 7 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, standardi euro 5, jo më pak se 5 (pesë) copë;



3





- c) Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, standardi euro 5, jo më pak se 1 (një) copë

- Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin "Specifikimet teknike", pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.
- Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:
- Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontratues. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të jenë gjendje për të siguruar plotësimin e gatishmërisë së mjeteve.
- Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdorast dhe për çdo shkak.
- Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave dhe kontenierëve.
- Të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve duhet të identifikohen sipas numrit respektiv të pikës, që duhet të jetë lehtësisht i dukshëm për komunitetin. Operatori i shërbimit mund të vendosë dukshëm numrat e pikave mbi njërin nga kontenierët apo ambjentet e tjerë rreth pikës sipas "Listës së pikave dhe vendodhjes së tyre".

2 Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve

2.1 Volumet e punimeve

4

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë **405 kontenierë** të volumeve 1.1 m³/, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontratues. Frekuenca e larjes së një konteneri është 1 herë në 60 ditë (1 herë/2 muaj).



2.2 Metodologjia

1. Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenierët çdo natë dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
2. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenierësh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenierët e larguar për tu larë.
3. Kontenierët për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucione larëse.
4. Me shërbim dezinfektimi kuptojmë realizimin e shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

2.3 Grafikët e punimeve

1. Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues.
2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut.
3. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre.

2.4 Rregulla për tu zbatuar

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane, tregjeve, etj..

2.5 Mjetet dhe pajisjet

1. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se **1 (një) copë**, standardi euro 5.
2. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese (dezinfektues kimik) për dezinfektimin e kontenierëve.
3. Operatori i shërbimit duhet të krijojë kushtet e nevojshme për larjen me presion dhe dezinfektimin e kontenierëve.



4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

5. Dezinfektimi dhe deratizimi kryhet me dizinfektues kimikë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

3 Fshirja e rrugëve dhe trotuareve me krahë dhe mirëmbajtja e rrugëve ditën.

3.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotuaret e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 261758 m² në ditë në Qytet dhe përkatësisht 77410 m² në ditë në Njësine Administrative Buçimas dhe 66000 në Njësine Administrative Udënisht. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për qytetin Pogradecit dhe Njësine Administrative Buçimas dhe Udënisht. Ky shërbim do të kryhet 7 herë/javë.

3.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

a. Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore, duke mbuluar sipërfaqen e plotë të trotuarit dhe një sipërfaqe rruge 2 m nga kuneta, në gjithë gjatësinë lineare të saj për rrugët e kryesore, si dhe sipërfaqen e plotë rrugë + trotuar për rrugët e tjera (që nuk mbulohen me shërbim të fshirjes me makineri apo larjes)

b. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo kur ka pengesa të tjera) Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë.

c. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.

d. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit (fshirjes) pastrojnë çdo lloj mbeturine që ka mbetur nga procesi i fshirjes, në mënyrë që rrugët të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.

e. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat rrugorë brenda zonës së kontraktuar. Për këtë operojnë punëtorë dhe makina të veçanta. Shërbimi i zbrazjes dhe pastrimit të ambjentit rreth tyre bëhet gjatë natës.



3.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00 dhe mirembajtja ditë nga ora 10:00-19:00 e kombinuar me turne sipas nevojës që do të ketë.

b. Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara Autoriteti kontratues mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njërës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit. Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga sipërmarresja dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbytjen e tyre.

3.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.

b. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

c. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoba për mosplotësim të tyre.

3.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazane dore lëvizëse dhe karroca dore.

4 Fshirja e rrugëve me makineri teknologjike.

4.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe gjatësitë lineare për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqje prej **30000 m²**. Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për qytetin e Pogradecit. Ky shërbim do të kryhet 1 herë në javë ose 52 herë në vit.

4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes së rrugëve me makineri konsiston në:

- a. Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve duke mbuluar gjithë gjatësinë lineare të lirë nga parkimi. Më pas çdo mbeturinë e mbetur nga pastrimi me mjete teknologjike, pastrohet nga punëtorët e shërbimit të fshirjes me krahë..
- b. Në të gjitha gjatësitë lineare dhe segmentet e lira nga parkimi, të rrugëve kryesore, të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri. fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike.

4.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- a. Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 21.00-04.00.
- b. Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontratues, me qëllim që në orën 7.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër.
- c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.

- d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:

8

1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
2. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

4.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.

c. Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja e rrugës me makineri teknologjike kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 5-10 km /orë.

d. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.

4.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

c. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 5- 6.5 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, standardi euro 5, jo më pak se 1 (një) copë;

d. Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:



a. Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e rrugëve, do të kontrollohen çdo 6 muaj nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

b. Çdo makineri për fshirjen e rrugëve duhet të lahen dhe pastrohen në fillim ose në fund të itinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.

a. Automjetet, pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kësaj kontrate.

5 Larja e rrugëve me makinë teknologjike dhe larja e speciale e shesheve me uje me presion

5.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre që do të lahen me presion për të gjithë zonën e kontraktuar si për shërbimin e parë të larjes gjatë natës ashtu dhe për shërbimin e dytë të larjes gjatë ditës.

1. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të rrugëve me makinë teknologjike, si shërbim dy herë në ditë gjatë sezonit veror për 183 ditë në vit, parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe sheshet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej 18 6000 m² në ditë përgjatë 6 muajve të vitit (gjithsej 183 ditë në vit).

Këto janë parashikuar në listën e rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e larjes me makineri për qytetin e Pogradecit.

2. Operatori i shërbimit do të bëjë larjen me presion të qendrës dhe disa shesheve të përcaktuar në harta me makineri si larje gjatë ditës në një sipërfaqe të përgjithshme prej 20000 m²/ditë, përgjatë 3 muajve më të nxehtë të vitit një herë në javë. (gjithsej 12 ditë në vit.)

5.2 Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston në:

1. Larjen me presion me makineri teknologjike larëse, si shërbim një herë në ditë, të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

2. Larjen me presion, me makineri teknologjike larëse, si shërbim i dytë ditor, të të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve dytësore të parashikuara për këtë shërbim, në mënyrë që makinat larëse të mbulojnë me shërbim të gjitha sipërfaqet e plota të tyre brenda kohës së parashikuar.

3. Gjatë shërbimit të parë të larjes (natës) shpejtësia e operimit të makinave larëse gjatë procesit të larjes (zbrazjes së ujit) duhet të variojë nga 8-10 km/orë kurse gjatë shërbimit të dytë të larjes nga 15-20 km/orë.



5.3 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

1. Larja e rrugëve, si shërbim një herë në ditë, do të bëhet çdo ditë, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) të rrugëve, nga ora 24.00-07.00.
2. Larja e rrugëve si shërbim i dytë ditor, do bëhet çdo ditë, gjatë periudhës 1 Prill – 30 Shtator, nga ora 12.00 –16.00.
3. Larja me presion, me makinë teknologjike do të kryhet me grafikë të miratuar nga Autoriteti kontratues, me qëllim që në orën 07.00 dhe në orën 16.00 për shërbimin e dytë të larjes, zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e larë.
4. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes së rrugëve, përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontratues këto ndryshime.
5. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar. 2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
6. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
7. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penaltete, gjopa dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

5.4 Rregulla për tu zbatuar

1. Autoriteti kontratues ka të drejtë të kontrollojë gjatë kryerjes së shërbimit dhe pas përfundimit të tij, respektimin e standarteve në presionin e ujit për larje si dhe duke kontrolluar herë pas here sasinë e ujit të përdorur për larjen e sipërfaqes së parashikuar. Në rastet kur evidentohet presion i pamjaftueshëm në larje apo sasi e vogël e ujit të përdorur, shërbimi i larjes do të konsiderohet i pavlefshëm.
2. Operatori i Shërbimit duhet të kryejë shërbimin e larjes me presion të rrugëve duke respektuar standartin e harxhimit të 0,8 litër ujë për 1 m² rrugë për larjen e darkës dhe 0.6 litër ujë për m² për larjen e ditës.
3. Larja duhet të bëhet me ujë me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 E coli për 100ml ujë.



4. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes me makineri për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.

5. Autoriteti kontratues do të nxisë Operatori i shërbimit të përdorë burime të tjera për sigurimin e ujit për larjen e rrugëve, si puse, etj.

6. Listat përkatëse të rrugëve që do lahen i bashkëngjiten kësaj kontrate.

7. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larje, do mbarten nga operatori i shërbimit.

8. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për larjen e rrugëve.

5.5 Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

1. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10000 litra ujë, standardi euro 5, jo më pak se 1 (nje) copë; Të jetë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

2. Automjetet të cilat duhet të përdoren për larjen e rrugëve duhet të inspektohen çdo 6 muaj nga Autoriteti kontratues. Çdo makineri për larjen e rrugëve duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.

3. Të gjitha makinat për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë, si dhe të jenë të lyera me të njëjtën ngjyrë.

4. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

5. Një listë e makinave larëse do t'i paraqitet Autoritetit kontratues para fillimit të veprimtarisë së larjes.

6. Mirëmbajtje lumenjsh dhe pastrim i thellë lumenjsh.

Volumet e punimeve, Specifikimet teknike dhe metodologjia



Nga eksperiencia e Bashkisë Pogradec është konstatuar që shumica e mbetjeve që depozitohen në liqen duke e ndotura të janë lumenjtë të cilët derdhen në Liqenin e Ohrit, për këtë arsye Bashkia Pogradec ka planifikuar në këtë kontratë Pastrimin e thellë të lumenjve në Qytet dhe në Njësitë Administrative për të parandaluar derdhjen e mbetjeve të ngurta dhe mbetjeve urbane të qytetit duke minimizuar derdhjen e tyre në liqen.

6.1 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

1. Mirëmbajtja e lumenjve do të kryhet dy herë në javë nëpërmjet puntorëve të cilët do të jenë të pajisur me mjete pune si lopata, karrocaetj. Ndërsa pastrimi i thellë i lumenjve është parashikuar të kryhet me mjete Eskavator dhe do të kryhet dy herë në vit për lumenjtë Lumi i qytetit dhe Lumi i Vërdovës, dhe një herë në vit Guri i Kuq, Mëmëlisht, Rrëmënj, Guras, Lumi Cerrave).

2. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit 2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

3. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

2. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjopa dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre

6.2 Mjetet dhe pajisjet

Për këtë shërbim janë parashikuar një mjete eskavator, 1 cili do të mundësojë pastrimin e lumenjve në thellësi dhe një kamjon.

7. Pastrim rrugesh dhe trotuaresh nga debora dhe kripësja e tyre

7.1 Volumet e punimeve.

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët dhe sipërfaqet e tyre në të cilat do të kryhet shërbimi i pastrimit të rrugëve nga debora dhe kripësja e tyre.

Operatori i shërbimit do të kryejë këtë shërbim për mesatarisht 10 ditë në vit në sipas metodologjisë së përcaktuar në zonën e kontratës, në përputhje me listën e rrugëve dhe hartën treguese bashkëngjitur.

7.2 Plani i punës dhe grafiku i punimeve

13



1. Pastrimi I rugeve dhe trotuareve nga debora dhe kripja e tyre do te behet gjate periudhes se dimrit ne kohen kur keto ruge dhe trotuare jane te bllokuara nga rreshjet e shumta te debores dhe pengojne qarkullimin normal te mjeteve dhe kembesoreve.
2. Orari I ketij sherbimi eshte I papercaktuar per vete faktin se do te kryhet kur te jete e nevojshme nderhyrja ne kete sherbim.
3. Operatori I sherbimit do te krycje kete sherbim sipas listes se rugeve dhe trotuareve , volumeve te percaktuara si dhe hartes treguese bashkengjitur .
4. Autoriteti kontratues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e ketij sherbimi dhe per te vendosur penalitete , gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

7.3 Rregulla per t'uzbatuar

1. Autoriteti kontratues do te inspektoje gjate ose pas perfundimit te sherbimit per te siguruar rigorozisht efektivitetin e ketij sherbimi dhe cilesine e kerkuar.
2. Perfaqesues te Autoritetit kontratues do te shenojne ne procesverbalet ditore dhe mujore te gjitha ditet dhe volumet qe do te kryhet ky sherbim per efekt te pageses se operatorit te sherbimit.
3. Operatori I sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite(osen ate) ne pune minimalisht numrin e kerkuar te makinerive dhe pajisjeve per kete sherbim.

7.4 Mjetet dhe pajisjet

Operatori I sherbimit duhet te siguroje per realizimin e pastrimit te rugeve dhe trotuareve nga Debora si dhe kripjen e tyre keto mjete :

1. Borepastruese, 1(nje) cope , te jete e pajisur me mekanizmin e hedhjes se kripes.
2. Automjetet qe do perdoren per kete sherbim do te inspektohen jo me pak se nje here ne vit nga Autoriteti kontratues.
3. Te gjitha makinerite per kete sherbim duhet te jene te regjistruara nga autoriteti kontratues , te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire.
4. Nje sasi e konsiderueshme kripe dhe pjeseve te nderrimit duhet te mbahen gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshem te kontrates.

8. Ngarkim pastrim inerte + transportin e mbetjet qe nxirren nga liqeni.

Volumet e punimeve, Specifikimet teknike dhe metodologjia

Për ngarkimin dhe pastrimin e inerteve janë parashikuar mbetjet inerte që do të hidhen nga banorët e paidentifikuar dhe kompania kontraktuese do të bëjë të mundur largimin e tyre me mjetet transportuese. Kurse për transportin e mbetjeve të nxjerra nga liqeni është parashikuar që grumbullimi i tyre të bëhet nga punonjësit e bashkisë pogradec dhe firma kontraktuese të bëjë të mundur vetëm largimin e tyre në drejtim të vendit ku është parashikuar depozitimi i tyre.

8.1 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

14

1. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit 2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.



2. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

3. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërbushjen e tyre

8.2 Mjetet dhe pajisjet

Për këtë shërbim është parashikuar një mjet kamion 3.5 deri 5 ton dhe një fadrome për ngarkim + mjetet e tjera kazma, Lopata, fshesa të cilët do të mundësojnë pastrimin dhe ngarkimin e tyre.

9. Pastrimi dhe largimi i mbeturinave nga koshat e vegjel

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e 180 kontenierëve me volum 12 l, brenda zonës së kontraktuar.

Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, 360 zbrazje kontenierësh/ditë, 180 kontenierë në qytet, si dhe largimi i mbetjeve çdo ditë dhe depozitimin e tyre në kontenieret 1.1 m³ të vendosur në qytet.

9.1 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i Pastrimit dhe largimi i mbeturinave nga koshat e vegjel konsiston në:

a. Zbrazjen e koshave dhe transportin e mbetjeve të gjeneruara prej tyre për në kontenieret 1.1 m³ të vendosur në qytet.

10. Plugim, lesim dhe pastrim i Rrës së plazhit me makineri të posaçme

Për këtë shërbim është parashikuar një mjet traktor me goma, me kapacitet 40-60 kuaj fuqi, i pajisur me plug dhe frezë për pastrimin në thellësi të rrës, e cila do të realizohet një herë në Vit, përpara fillimit të sezonit turistik.

GRUPI I PUNËS:

Bashkim Lashioti Bashkim
Violeta Cetani AS
MEKHAT SHKURPA Atyris
SPARKE KUQAR JKR
Klodi Bregani Φ

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE

ILIR XHAKOLLI



TABELA PERMBLEDHESJE QYTETI POGRADEC

Duke nxjerrë shpenzimet për çdo zë pune më poshtë po paraqesim preventivin e plotë 4-vjeçar i cili përbehet nga këto shprehje

Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETJEVE TE QYTETIT POGRADEC

NR	DITE PUNE 4 VJET	EMERTIMI SHERBIMEVE	NJESIA	SASIA NE DITE	CMIMI/njesi	dite pune vit	VLERA
1	1460	Fshirje sipërfaqe të asfaltuara me krahe	m ²	261,758.00	0.204	365	77,962,003
2	1460	Mirembajtje e rrugëve	m ²	261,758.00	0.057	365	21,783,501
3	208	Fshirje sipërfaqe të asfaltuara me makineri	m ²	30,000.00	0.429	52	2,676,960
4	1460	Grumbullim dhe transport urban	Zbraze	198.00	318.008	365	91,929,747
5	800	Ngarkim pastrim inert + mbetjet që nxirren nga ligjeni	Ton	5.00	2625.000	200	10,500,000
6	960	Desifektim kontejneresh	m ²	130.00	21.000	240	2,620,800
7	732	Lagje dhe frskim rrugeshrrugesh	m ²	186,000	0.175	183	23,826,600
8	416	Mirembajtje lumit i qytetit	dite pune	1.00	1870.000	104	777,920
9	8	Pastrim i thellë lumenjsh me eskavatore Lumi të qytetit dhe lumit të Verdovës	dite pune	1.00	802170	2	6,417,360
10	48	Larje speciale e shesheve 4 here muaj	m ²	20,000.00	0.824	12	791,040
11	40	Pastrim nga bora dhe kriposje	dite pune	1.00	70476.7	10	2,819,068

08

4/11

Abdull

20/11

P

12	28	Plugim dhe lesim i reres se plazhit dhe pastim me makineri te posacme	m2	75,000.00	0.208	7	436,800
13	1460	Pastrimi i mbetjeve nga koshat e vegjel	cope	180.00	46.0	365	42,088,800
							254,630,598.34
							50,926,119.67
		T.V.SH 20%					305,556,718.01
	TOTALI						

GRUPIT PUNES:

Bardhyl Isufendi
Violote Gazoni
SPARRE KUQ
NEXHAT SHTRITA
Klaudio BIZGJONI

* Pika 4 është parashikuar që në një ditë të grumbullohen 40.7 ton mbetje urbane në Qytet + Njesite Administrative, të cilat do të konvertohen në zbraze kazan ku sipas tonazhit nevojten 405 zbraze në ditë, ky konvertim është bërë për arsyer e mëposhtme :

- 1-Rrit efijencen e shërbimit
- 2-Në Njesite Administrative kemi një shërbim gjeografik me të madhe dhe nevojten me shume konteniene pavarasht normes se gjenerimit per banor.
- 3-Nese gjithe kohezgjatjes se kontrates kemi tejkalim te normes mesatare te tonazhit. ulim rriskun e tejkallimit te koston mesatar te llogaritur ne nje vit.
- 4- Bashkia Pogradec nuk disponon peshore për peshimin çdo ditë para nises së mjeteve për në landfill Maliq, prandaj në këtë mënyre mund të ketë edhe abuzime nga ana e operatorit të pastrimit duke shtuar artificialisht peshën e mbetjeve të depozituat duke marrë edhe mbetje nga vende të tjera gjë që sjell rëndimin e koston financiare te tarifes që Bashkia Pogradec paguan për tjetimin e mbetjeve në landfill Maliq.

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE

Ilir XHAKOLLI



Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETJEVE TE NJESISE ADMINISTRATIVE BUCMAS

NR	DITE PUNE 4 VJET	EMERTIMI SHERBIMEVE	NJESIA	SASIA NE DITE	CMIMI	dite pune vit	VLERA
1	416	Fshirje sipërfaqe të asfaltuara me krahë	m2/dite	77,410.00	0.17	104	5,474,435
2	1460	Mirëmbajtje e rrugëve	m2/dite	77,410.00	0.02	365	2,260,372
3	1460	Grumbullim dhe transport urban	Zbrastje	80.00	462.70	365	54,043,438
4	960	Deshtëkim konteneresh	cop	80.00	21.000	240	1,612,800
5	360	Lagje rrugësh	m2/dite	16,000.00	0.485	90	2,793,600
6	216	Mirëmbajtje lumi	dite pune	1.00	1,870	54	403,920
7	4	Pastrim i thellë lumi guras	here	1.00	986,432	1	3,945,728
		SHUMA					70,534,293.44
		T.V.SH 20%					14,106,858.69
		TOTALI					84,641,152.13

GRUPI PUNES:

Barshy Leutheky Brouk
Violeta Cedomir
JAPRIME KUCI
VENERAT JHIMIN HIRSHI
Kloj Baryoni

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
Ilir XHAKOLLI



Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETJEVE TE NJESISE ADMINISTRATIVE UDE NISHTA

NR	DITE PUNE 4 VJET	EMERTIMI SHERBIMEVE	NJESIA	SASIA NE DITE	CMIM (qesi)	dite pune vit	VLERA
1	416	Fshirje sferace te asfaltuara me krahe	m2	66,000.00	0.2000	104	5,491,200
2	1460	Mentebaze e rrugëve	m2	66,000.00	0.0300	365	2,890,800
3	1460	Ngratim dhe transport mbetjesh	Zbraze	50.00	436,9517	365	31,897,472
4	960	Desifektim i kontenerëve	cop	50.00	21	240	1,008,000
5	360	Lage rrugesh	m2	12,000.00	0.4850	90	2,095,200
6	4	Pastrim i thelle lumenjsh	dite pune	1.00	305,995	1	1,223,980
		SHUMA					44,606,652
		T.V SH 20%					8,921,330.36
		TOTALI					53,527,982

GRUPI I PUNES:

Barshy Leartebeti Shumy
Violeta Cetani D-S
SPEKTR EUG
NEKETE ANTONI ARTHUR
Klaja Brijoni P

MIRATOHEJ
KRYETARI I BASHKISE

Ilir XHAXHOLLI



Objekt: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETJEVE TE NJESISE ADMINISTRATIVE ÇERRAVE + DARDHAS

NR	DITE PUNE 4 VJET	EMERTIMI SHERBIMEVE	NJESIA	SASIA NE DITE	CIMIMI (njesi)	dite pune vit	VLERA
1	1480	Nga krenatransport mbeturinash	Zonazje	50	380.41	365	27,769,698
2	960	Deshtëkimi i kontenerëve	cop	50.00	21.0000	240	1,008,000
3	216	Mërmëzajtje lumi Çerrave	m2	1.00	1.732	34	374,112
4	4	Pasttrim i thellë i lumenjve	haire	1.00	392.560	1	1,570,240
		SHUMA					30,722,050
		T.V SH 20%					6,144,410
		TOTALI					36,866,461

GRUPI I PUNES:

Enxhela Tushaj
Violeta Cekan, ORG
SPHEREAL E VDS
NEXHAT SHUMHA Hoxha
Klojd Bizjan, DARDHAS

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
Ilië AHIAKOLLI



Objekti: PASTRIMI, GRUMBULLIMI DHE LARGIMI I MBETJEVE TE NJESIVE PROPTISHT, VELÇANJE DHE MBIRRI

NR	DITE PUNE 4 VJET	EMERTIMI SHERBIMEVE	NJESIA	SASIA NE DITE	CMIMI(njes)	dite pune vit	VLERA
1		Ngarkim+transport mbeturinash	Zorëzje	95.00	298.78	312	35,423,628
2	2	Destektimi i kontajnerëve	cop	95.00	21.0000	52	414,960
		SHKUMA					35,838,588
		T.V.SH. 20 %					7,167,718
		TOTALI					43,006,306

GRUPI I PUNES:

Barshaj Tahir
Violeta Ceroni
SPERIANE KUCI
NEKASTHINJA MURDO
KLOYD BRYSON

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
Ili XHAKOLLI

PREVENTIV FINAL				
	4 VITE		1 VIT	
Njesia	Pogradec 2 here	KONTEINERE		
Pogradec	305,556,718	Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shitesë)		76,389,180
Udenisht	53,527,982	Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shitesë)		13,381,996
Cerrave	35,733,254			8,933,314
Bucimas	84,641,152	Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shitesë)		21,160,288
Proptisht Trebinje Velçan	43,006,306	Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shitesë)		10,751,576
0		Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shitesë)		
0		Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shitesë)		
0		Kazanë/qese ekstra (dëmtim ose nevoja shitesë)		
TOTAL	522,465,413	0		130,616,353

130,616,353

GRUPI I PUNES:

Rodhuf Isartirali Nume
Violeta Cetani
NEXHAT SHKURIA Aben
SPMINE KUO
Klajti Brzjan

